

KUVENDI KOMUNAL I MITROVICËS SË JUGUT



**Raporti vjetor i Komisionit Komunal të
Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve”
sh.a. për vitin 2023**

Mitrovicë, 2024

Përmbajtja

- 1. Përmbledhje e përgjithshme e punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobuseve”, sh.a.**
- 2. Informata për pasqyrat financiare periudhën 01/01/2023 deri më 31/12/2023**
- 3. Konkluzione**

1. Përmbledhje e përgjithshme e punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL “Stacioni i autobuseve”

Raporti vjetor për vitin 2023 është përmbledhje e punës, aktiviteteve dhe angazhimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL "Stacioni i autobuseve" në Mitrovicë, si dhe zhvillimeve në ndërmarrje. Komisioni Komunal i aksionareve, i përbër prej tre anëtarëve, gjatë vitit 2023 ka zhvilluar gjithsej 4 takime, në të cilat është diskutuar për gjendjen në ndërmarrje dhe janë marrë disa vendime që janë vlerësuar me interes të zhvillimit të ndërmarrjes. Në disa prej takimeve të mbajtura present kanë qenë edhe anëtarët e bordit të ndërmarrjes. Si komision komunal, në vazhdim të përpjekjeve për konsolidimin e ndërmarrjes, në kuptim të rimëkëmbjes së saj, në shkurt të viti 2023 kemi mbajtur takime pune ndërsektoriale me pjesëmarrjen e zyrtarëve të Policisë së Kosovës, Drejtorinë e shërbimeve publike dhe atë të Inspektionit, ku kemi kërkuar përkrahje në suaza të kompetencave dhe kemi marrë zotimin që do të kemi bashkëpunim të ngushtë për çështje që mund të jenë objekt i përbashkët i trajtimit, si çështjet e mbikqyrjes së linjave të transportit urban etj.

Po ashtu në kuptim të inkasimit të të ardhurave, NPL “Stacioni i autobusëve”, në raport me vitet paraprake, ka shënuar porgres si në kuptimin e shumës së inkasuar ashtu edhe në kuptim të efikasitetit të inkasimit për shërbimet e ofruara. Kështu, nëse bëjmë krahasime ndër vite rezulton si në vijim:

Nga shërbimet e peronizimit dhe parkingut në vitin 2022 ndërmarrja kishte realizuar të hyra në vlerë prej 48.333 eurosh, ndërsa në vitin 2023 nga të njëjtat shërbime janë inkasuar 61.108 euro, rrjedhimisht 31 % më shumë. Nga shërbimet e qirasë ndërmarrja në vitin 2022 kishte realizuar 38,401 euro të hyra, ndërsa në vitin 2023 shuma e mjeteve të inkasuara kishte arritur vlerën 41,966 euro, d.m.th. 9 % më shumë. Ndërmarrja ka arritur që në vitin 2023 të realizojë edhe të hyra tjera në vlerën prej 62.713 eurosh. Kjo nënkupton që, referuar të dhënave statistikore të sipërcekura, rezulton konkulozioni i përgjithshëm se ndërmarrja në vitin 2023 ka shënuar rritje të të hyrave në vlerën prej

165,787 eurosh, pra rreth 79,053 euro më shumë sesa në vitin paraprak, apo shprehur në përqindje, 91 % më shumë.

Referuar çështjes së shpenzimeve të pagave, në vitin 2023 shuma totale arrinë vlerë në 92,559 euro, në raport me vitin paraprak, pra vitin 2022 ku shuma e totalit të shpenzimeve për paga ishte 87,071. Rritja e shpenzimeve për 5,488 euro është rezultat i kryerjes së pagesave (pagave) me rregull për anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Ndërsa, referuar shumës totale të shpenzimeve operative, në NPL “Stacioni i autobusëve” janë krijuar shpenzime të pashmangshme, të domosdoshme në vlerë prej 32,345 eurosh, dhe shpenzime administrative në vlerën 10,820 euro.

Ashtu sikur keni qenë të njoftuar, në vitin e kaluar gjendja e NPL “Stacioni i autobusëve” sh.a. në Mitrovicë ishte e rënduar për faktin se kishte probleme të theksuara të natyrës administrative dhe organizative. Me probleme të tilla, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për ta përmirësuar gjendjen, kjo ndërmarrja akoma vazhdon të përballet me probleme të natyrave të ndryshme, vecanërisht me problemet e infrastrukturës së objektit në përgjithësi, ngase për një kohë të gjatë, afërsisht një dekadë, nuk ka pasur përkujdesje as minimale nga ana e menaxhmenteve të kaluara të saj. Përtej problemeve të sipërcekura, stacioni i autobusëve kishte probleme të theksuara edhe me aspekte juridike. Ishte evidente mungesa e akteve nënligjore, mbi bazën e të cilave, në kushte normale, do të duhej të funksiononte dhe organizohej një ndërmarrje. Si kusht i parë i pakalueshëm dhe i domosdoshëm ishte nxjerrja e akteve nënligjore mbi bazën e të cilave ndërmarrja do të zhvillojë veprimtarinë e saj në baza legale. Për rrjedhojë, si KKA në takimet tona të përbashkëta me BD kemi theksuar nevojën e korrigjimit të Statutit të ndërmarrjes, duke inkorporuar plotësim-ndryshimet e nevojshme në harmoni me ligjet në fuqi. Në këtë drejtim në fillim të uajit shkurt ka përfunduar punën komisioni përkatës dhe më datën 14.02.2023 është bërë ndryshim-plotësimi i statutit të ndërmarrjes lokale “Stacioni i Autobusëve.

Mungesa e licences dhe deficiti i e stafit menaxherial dhe operativ ishte një problem tjetër që ndërmarrja kishte trashëguar me vite. Përtej preokupimit tonë si KKA, ky problem ishte një obligim ligjor që duhej përmbushur nga NPL “Stacioni i Autobusëve”. Falë një pune sistematike dhe përkushtimit bëhet licencimi i ndërmarrjes publike lokale

“Stacioni i Autobusëve” sh.a. nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër licence 003/23 në kategorin “B” e lejuar më datë 02.03.2023 dhe valide deri më datë 03.03.2028. Gjatë vitit 2023 ndërmarrja poashtu ka arritur edhe disa rezultate që vlen të theksohen si:

- Më datën 23.02.2023 është nënshkruar marrëveshja – kontrata për kryerjen e shërbimeve postare me Postën e Kosovës.
- Më datën 10.03.2023 kryeshefi ekzekutiv nxjerr vendim për lirim të hapësirave (lokaleve) të uzurpuara në ndërmarrje.
- Më datën 07.04.2023 është aprovuar/miratur nga Komisioni Aksionareve dhe Bordi i Drejtorëve “Rregullorja për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a.
- Më datën 06.06.2023, me nr. të protokollit 92/23, është aprovuar Plani i Biznesit për vitin 2023.
- Më datën 30.06.2023, me nr. rendor/112, është arritur marrëveshja dhe është nënshkruar kontrata ndërmjet “Arjeta Group” dhe NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. për dhënie në shfrytëzim me qira të hapësirave të caktuara të ndërmarrjes.
- Gjatë vitit 2023 është realizuar transferimi dhe rinovimi i zyrave nga pjesa ballore e stacionit në katin e tretë të administratës së ndërtesës.

Janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore së bashku me drejtoritë kompetente të Komunes së Mitrovicës, si dhe Policisë të Kosovës, për lirim të objekteve të uzurpuara, ku ky proces është duke vazhduar.

Zyra e financave është pajisur me softver financiar i cili mbulon boshëllokun e mëparshëm, duke pasur parasysh që shënimet dhe regjistrimet janë mbajtur me excel.

Në negociatën me Policinë e Kosovës është vendosur të lejohet një zyrë aktive në të cilën do të vendosen zyrtarët e PK-së.

Është bërë njoftimi për kontraktorët borxhlinjë për procedurat përbarimore të përbaruesit privatë.

Është rregulluar çështja e ndriçimit të peronave, si hap i domosdoshëm.

Është instaluar zyrtarisht E-Prokurimi në faqen zyrtare të KRPP-së.

Janë nënshkruar disa kontrata të rregullta duke u bazuar në “Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të NPL “Stacioni i Autobusëve” me operatorët ekonomik.

Nga takimet e realizuara me Bordin Drejtues që nga fillimi kemi qenë pro faktit që ndërmarrja ka nevojë t’i nënshtrohet një procesi të auditimit me qëllim të hulumtimit dhe analizimit të gjendjes së përgjithshme në ndërmarrje. Ky proces tashmë ka ndodhur në pjesën e dytë të vitit 2023, për herë të parë pas shumë vitesh. Nga BD jemi njoftuar se NPL “Stacioni i Autobusëve” i është nënshtruar procesit të auditimit të jashtëm për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Pas përfundimit të këtij procesi jemi njoftuar nga të njëjtit me të gjeturat e auditorit për ngecje në 12 pika. Me të njoftuar me të gjeturat në fjalë, si komision aksionar nga bordi kemi kërkuar që të fillohet implementimi i të njëjtave, duke pasur parasysh prioritet. Kështu, menaxhmenti i ndërmarrjes ka arritur të implementojë gjashtë rekomandime¹, katër janë në proces e sipër dhe dy nuk kanë filluar akoma për shkak të kompleksitetit të çështjeve.

2. Tabela nr. 1. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, 31.12.2023

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	Shuma (€)
Të hyrat	165,823
Pagat	93,809
Kosto operative	32,345
Kosto administrative	10,820
Fitimi para tatimit (EBIT)	28,848

¹ Me rëndësi të vecantë që vlen të theksohet është funksionalizimi i E-Prokurtimit. Ky proces do të ndihmojë shumë ndërmarrjen për zhvillimin e procedurave ligjore, si dhe për funksionimin sa më efikas të saj në përgjithësi.

3. Konkluzionet

Nga prezantimi i gjendjes së përgjithshme të NPL “Stacioni i Autobusëve”, ofrimit të të dhënave me rëndësi (përshkrimit faktik) rezulton që ndërmarrja, përkundër problemeve të mëdha të trashëguara me të cilat është ballafaquar, ka shënuar relativisht progres. Progresi në ndërmarrje, edhe pse jo i kënaqshëm, duke pasur parasysh objektivat dhe vizionin e KKA, BD dhe menaxhmentit, reflekton nevojat e zhvillimit të ndërmarrjes. Kur themi këtë kemi parasysh faktin se në të gjitha aspektet, si organizative ashtu edhe në ato të infrastrukturës fizike dhe ligjore, ka zhvillime positive dhe vërehën përpjekje të vazhdueshme nga ana e akterëve relevantë për të ndryshuar gjendjen e ndërmarrjes në kuptimin pozitiv.

Në aspektin organizativ ndërmarrja ka bërë përpjekje në rekrutimin e kuadrit profesional të nevojshëm dhe konsolidim financiar. Në aspektin e infrastrukturës fizike ndërmarrja ka ndërmarrë veprime konkrete duke intervernuar në ndricimin e peronave, rinovimin e disa hapësirave fizike të ndërmarrjes dhe pajisjen e zyrave me inventar të nevojshëm për kryerjen e punëve.

Në aspektin e infrastrukturës ligjore ndërmarrja ka bërë hapa konkretë në hartimin dhe aprovimin e akteve nenligjore, si:

1. Statutit, si akti themeltar dhe më i rëndësishëm i institucionit;
2. Rregullorja për dhënien në shfrytëzim të hapësirave të NPL “Stacioni i Autobusëve”;
3. Licencimi i ndërmarrjes.

Gjithashtu janë nënshkruar kontrata me rëndësi të vecantë me institucione të ndryshme në funksion të rritjes së funksionalitetit të ndërmarrjes.

Ne aspektin e ofrimit të shërbimeve ndërmarrja ka bërë një riorganizim në kuptimin e ofrimit të shërbimeve dhe inkasimit të të hyrave, duke ndarë kështu shërbimin e parkingut me atë të peronizimit. Ndërsa në aspektin e afarizmit ndërmarrja për herë të parë, pas pothuajse nje dekade, ka pasur afarizëm pozitiv, ku vlera e fitimit është 28,848 euro.

Mitrovicë, 2024

KKA, NPL “Stacioni i Autobusëve”

Florina Çitaku
Elvis Feka
Kushtrim Zeneli





NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
“STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.”
MITROVICË

NPL “Stacioni i Autobusëve” SH. A. Mitrovicë

RAPORTI VJETOR 2023

Mitrovicë, Janar 2024

NPL “ Stacioni i Autobusëve” SH.A. -
Rr.Mbretëresha Teutë p.n. – Mitrovicë
Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

1. Lista e shkurtesave - Hyrje	3
2. Informacione të përgjithshme.....	4
3. Permbledhje ekzekutive.....	5
4. Prezantimi.....	6
5. Pasqyra e strukture organizative.....	10
5.1. Informacioni i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore në ndërmarrje.....	10
5.2. Lëvizjet e stafit gjatë vitit 2023.....	10
6. Financat.....	11
6.1. Të hyrat.....	11
6.2. Shpenzimet – Kategoritë e shpenzimeve.....	12
6.2.1. Shpenzimet për paga dhe mëditje.....	12
6.2.2. Shpenzimet operative.....	12
6.2.3. Shpenzimet administrative.....	13
6.2.4. Shpenzimet investive.....	13
6.2.5. Shpenzimet e zhvlerësimit.....	13
6.2.6. Fitimi (humbja) para tatimit.....	13
7. Çështjet juridike.....	14
8. Transaksionet e prokurimit.....	15
8.1. Planifikimi për vitin vijues.....	15
TABELAT	
Tabela nr. 1 Të hyrat.....	11
Tabela nr. 2 Shpenzimet e pagave.....	11
Tabela nr. 3 Shpenzimet operative.....	11
Tabela nr. 4 Shpenzimet administrative.....	13
Tabela nr. 5 Shpenzimet e zhvlerësimit.....	13
Tabela nr. 6 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.....	13
Shtojca	
a. Organogrami.....	16

LISTA E SHKURTESAVE

RK – Republika e Kosoves

SAM - NPL “Stacionit të Autobusëve” SH.A. Mitrovicë

KM- Komuna e Mitrovices

TM1 - Tremujori i parë

TM2 - Tremujori i dytë

TM4 - Tremujori i tretë

TM4 - Tremujori i katërt

AKP - Agjencioni Kosovar i Privatizimit

ATK – Administrata Tatimore e Kosoves

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures

PK – Policia e Kosoves

1. HYRJE

Raporti vjetor për vitin 2023 paraqet realizimin e objektivave kryesore të NPL “Stacionit të Autobusëve” SH.A. Mitrovicë. Raporti vjetor është dokumenti bazë për menaxhimin e të gjitha resurseve në posedim të NPL “Stacionit të Autobusëve” SH.A. Mitrovicë, i hartuar për menaxhmentin, Bordin Drejtues, aksionarët dhe palët e treta.

Raporti vjetor është hartuar duke marrë parasysh informatat e vitit aktual dhe ofron pasqyra të detajuara lidhur me afarizmin e ndërmarrjes për periudhën janar-dhjetor të vitit 2023. Rëndësi e veçantë i është kushtuar shpalosjeve analitike të të gjitha pozicioneve relevante të aktivitetit operativ të ndërmarrjes.

Përmbajtja përshkruan afarizmin e zhvilluar për periudhën një vjeçare të bazuar në strategjinë zhvillimore me qëllim të vendimmarrjes efikase dhe optimale. Duke marrë për bazë rezultatet në periudhën paraprake, raporti definon çart riorientimet zhvillimore, objektivat dhe rezultatet e pritshme të NPL “Stacionit të Autobusëve” SH.A. Mitrovicë.

Në raportin vjetor, shpalosen synimet kryesore të NPL “Stacionit të Autobusëve” SH.A. Mitrovicë, realizimi i të cilave ka filluar t’i jetësoj objektivat strategjike zhvillimore të SAM, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e performancës së përgjithshme, ngritjen e produktivitetit dhe rikthimin e ndërmarrjes në kursin e rentabilitetit.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Emri i ndërmarrjes	NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Mitrovicë	
Shkurtesa	SAM	
Aksionar i ndërmarrjes	Komuna e Mitrovices (100% aksione)	
Komisioni i aksionarëve	1. Florina Çitaku	
	2. Kushtrim Zeneli	
	3. Elvis Feka	
Bordi i drejtoreve	1. Naim Hajrizi.....Kryesues	
	2. Naxhije Xhema.....Anëtar	
	3. Bislëm Ymeri.....Anëtar	
	4. Diellza Uka.....Anëtar	
	5. Esat Jusufi.....Kryeshef Ekzekutiv	
Kapitali fillestar i ndërmarrjes		1,271,735.84€
Hapësira (ha)		0.66 ha
Numri i peronave		19
Numri i hapësirave afariste		15
Buxheti për vitin 2023		165,823.00€
Shpenzimet për vitin 2023		136,975.00€
Struktura bazë e shpenzimeve	Shpenzimet e pagave68%	
	Shpenzimet operative.....24%	
	Shpenzimet tjera.....8%	
Numri i punëtoreve		22
Mosha mesatare		46
Struktura gjinore		15 meshkuj / 7 gra

3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2023 ishte periudhë e përcjellur me sfida të mëdha për ndërmarrjen. Me ndryshimin e menaxhmentit të ndërmarrjes në fund të vitit 2022 dhe në fillim të vitit 2023 janë bërë përpjekje nga komisioni aksionardhe Bordi Drejtues të bëhen ndryshime pozitive duke filluar një etapë të re të menaxhimit pozitiv të ndërmarrjes publike komunale e cila ka rëndësi të veçant. Ndërmarrja përveç që është urë lidhëse e shumë qyteteve të vendit tonë me pika të ndryshme vendore, regjionale dhe ndërkombëtare, ajo paraqet edhe një pasqyrë të rëndësishme jo vetëm të qytetit të Mitrovices, por edhe të Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet, duke filluar nga aspekti afarist, kulturor, social, funksional etj.

Viti 2023 fillon me një varg barrierash dhe problemesh të trashëguara të cilat e rënduan dukshëm afarizmin e ndërmarrjes. Barriera themelore ishte kufizimi buxhetor lidhur me riparimin e objektit i cili është degraduar në masë të madhe nga mos investimi pothuajse në tërë decienen e fundit. Barriera tjera me të cilat u sfiduar ishin edhe çështja e tarifave, kompletimi me staf të kualifikuar, rregullimi i ambienteve të punës, borxhet e trashëguara etj. Vlen të theksohet se stacioni vitet paraprake ka operuar pa licencë.

Ndërmarrja funksionon duke realizuar të hyra vetanake dhe subvencione nga buxheti komunal. Burimet kryesore të hyrave janë shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i parkingut, shërbimi i poligoneve për auto shkolla, qiradhënia e lokaleve afariste në pronësi të Stacionit dhe të hyra tjera.

Ne total gjatë vitit 2023 janë krijuar 165,823.00€ të hyra, të cilat krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 91.2%. Rritja e të hyrave për vleren prej 79,089.00€ e cila është realizuar rrjedh nga aktiviteti në ngritjen e ofrimit të shërbimeve cilësore, rritjen e shkallës së inkasimit, rritjen e efikasitetit në punë si dhe rritjen e kontrollit të brendshëm.

Edhe pse ka qene një vit mjaft i vështirë, menaxhmenti ka menaxhuar situatën duke i mbajtur shpenzimet nën kontrollë rigoroze. Krahasuar me vitin paraprak kemi nivel të rritjes së shpenzimeve në paga prej 7.7. Rritja e shpenzimeve totale ka ndodh si pasojë e rregullimit të peronave, zyreve dhe inventarizimin me pajisje të domosdoshme dhe elementare për punë. Gjatë vitit 2023, ndërmarrja ka operuar me një fitim para tatimit në vlerë prej 28,849.00€. Në fitimin e ndërmarrjes janë të inkorporuara edhe subvencionet e lejuara nga Komuna e Mitrovices.

Gjatë vitit të kaluar Zyra e Prokurimit ka zhvilluar dy procedura dhe aktivitete të prokurimit.

Ndërmarrja objektiv parësor ka vendosur përmirësimin e vazhdueshëm të komunikimit me palët me interes për ndërmarrjen duke vendosur një komunikim profesional me transportuesit, me bizneset të cilët i shfrytëzojnë hapësirat e ndërmarrjes me qira dhe sidomos me udhëtarët të cilët janë faktorë kryesorë në arritjen e suksesit të ndërmarrjes.

Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve, menaxhmenti ka paraparë që të bëhen investime të vazhdueshme në ngritjen e kapaciteteve të resurseve humane, përmes trajnimeve të ndryshme të cilat do të realizohen në bazë të nevojave të ndërmarrjes, me qëllim të arritjes së objektivave të synuara. Realizimi i këtij objekti për rrethana objektive në mungesë të mjeteve financiare nuk ka përfunduar por sado pak është përmbushur me pranimin e kuadrave të reja. Sa i përket investimeve kapitale, duke pas parasysh bashkëpunimin e ngusht me Komunen e Mitrovices, planifikohet me urgjencë meremetimi i kulmit të objektit, rregullimi i laurave, rrjetit të ujit dhe kanalizimit dhe disa lokaleve.

Po ashtu janë paraparë të bëhen investime tjera në objekt të cilat do të ndikojnë në rritjen e të hyrave e ndërmarrjes dhe mbarvajtjen e aktivitetit operativ të saj.

4. Prezantimi

Raporti vjetor bazohet në Ligjin mbi ndërmarrjet publike nr. 03/L-087, nenin 31, pika 31.3, ku qart përkruhet Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, duhet të përgadisnin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar në të cilin përkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura.

Prandaj bazuar në detyrimet dhe përgjegjësitë të cilat rrjedhin nga ligji mbi ndërmarrjet publike raporti prezanton në mënyrë të qartë të gjitha veprimet e ndërmarrja nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjes në realizimin e objektivave të parashtruara gjatë vitit të kaluar 2023.

Performanca afariste dhe financiare e ndërmarrjes paraqet dy kushtet kryesore lidhur me suksesin e gjithmbarshëm të ndërmarrjes. Prandaj kjo pjesë do të shpalojë në mënyrë të detajuar lidhur me të gjitha informacionet sa i përket të hyrave, shpenzimeve dhe pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit 2023.

Çështjet juridike posedojnë rëndësi të veçantë për ndërmarrjen, si rrjedhojë të njëjtat kanë ndikim të madh në suksesin dhe funksionimin e ndërmarrjes prandaj do të behet prezantimi i veprimeve të ndërmarrja që ndërmarrja të operojë në një ambient sa më të mirë të punës duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Gjendja e NPL "SAM" SH.A. Mitrovicë ishte e mjerushme për një kohë të gjatë dhe kjo është e ditur sepse nuk ka pasur as përkujdesje minimale as nga ana e stafit të NPL "SAM" SH.A., dhe as nga ana e institucionit që është aksionar 100%, kjo gjendje ka ekzistuar jo vetëm nga paslufta e deri më tani, por edhe më herët thënë më konkretisht që nga vitet e 90 nuk ka pasur asnjë përkujdesje.

Kryeshefi ekzekutiv ka marrë detyren me datë 10.01.2023. duke u ballafaquar me një varg problemesh të trashëguara.

Përveç problemeve administrative dhe organizative që janë akoma probleme të kësaj ndërmarrje, çështje tjera shtesë janë edhe problemet e infrastrukturës dhe objektit në përgjithësi sepse nuk ka pasur përkujdesje apo investime kapitale qoftë për rivitalizim të objektit apo edhe rimëkëmbje të ndërmarrjes në përgjithësi.

Vlen të ceket se pjesa më e shkatërruar e objektit në përgjithësi është kulmi sepse sikurse e kemi gjetur atë gjendje të rëndë, e që është vjedhur copa copa të llamarinës së bakrit ndër vite, pothuajse është demoluar dhe shkatërruar në pjesën më të madhe të tij.

Përveç objektit i cili pothuajse është jo funksional kemi gjetur edhe shumë probleme të tjera, si vijon:

NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. ka qenë i pa licensuar;

Lokali Darisi i lëshur pa kontrat për dy vite, dhe qira rreth 12.000.00€ të papaguara; dhe

Lokali i quajtur Parisi i uzurpuar me qira të papaguar rreth 19.000.00€, dhe më e keqja e funksionimit të këtij lokali ku dyshohet se është zhvilluar edhe prostitucioni, pastaj me probleme të keqëpërdorimit të energjisë elektrike të cilën nuk e ka paguar dhe borxhi ndaj KEDS-it është rreth 28.500.00€.

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve:

Borxhi ndaj ujësjellësit mbi 45.000.00€ si pasojë e një defekti të brendshëm dhe nuk është ndërmarr asnjë iniciativë për sanimin e këtij defekti;

Trusti pensional për punonjësit e NPL-së është i papaguar për disa vite shuma është 122,791.96€;

Pagat e disa punëtorëve janë akoma të pa paguara;

NPL "SAM" SH.A. nuk ka pasur kontrata të shërbimeve me asnjërin nga operatorët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e transportit publik në relacionet sipas rrethave të udhëtimit në atë urban dhe ndërrurban dhe borxhi ndaj ATK-së është mbi 500.000.00€ i grumbulluar ndërvite.

Hapat e ndërmarrë për zgjedhjen e këtyre problemeve janë si vijon:

Kemi bërë licencimin e ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër licence 003/23 në kategorinë "B" e lejuar me datë 02.03.2023 dhe valide gjerë më datë 03.03.2028.

Është bërë ndryshim plotësimi i "Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve" Sh.A.

Transferimi i zyreve nga pjesa balllore e stacionit në katin e tretë të ndërtesës së Administratës, ku është dashur të bëhet meremetimi i zyrave. Në suaza të kësaj nga kontaktet me Komunen e Mitrovicës kemi pranuar donacion me karrike dhe tavolina të nevojshme për funksionimin e zyrave. Kemi rregulluar rrymën elektrike, lidhjet me internet, blerjen e kompjuterëve dhe paisjeve tjera të nevojshme për funksionalizim e zyreve.

Është hartuar "RREGULLORJA PËR DHËNJËN ME QIRA TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË NDERMARRJËS PUBLIKE LOKALE".

Kemi ndërmarr veprimet e duhura ligjore së bashku me drejtorinë kompetente të Komunes së Mitrovicës, si dhe Policisë të Kosovës (PK) për lirin e objekteve të uzurpuara.

Aktivitet tjetër relevant është heqja e mbulojës së bakrit nga kulmi, të cilat nga era e fort rrezikonte seriozisht aktivitetin e funksionimit të stacionit. Heqja emergjente e mbulojës së bakrit ishte e kushtëzuar nga rreziku permanent për lëvizjen e qytetarëve dhe të punësuarëve si dhe operatorëve ekonomik. E njëjta është shitur me procedura të përshpejtuara. Shitja emergjente ka ndodhur si pasojë e mungesës së depos për ruajtjen e mallit dhe punëtorëve të sigurimit.

Zyra e financave është paisur me softver financiar i cili mbulon boshëllokun e mëparshëm duke pas parasysh që shënimet dhe regjistrimet janë mbajtur me excel.

Në negociata me PK kemi vendosur ta lejojmë një zyre aktive në të cilën do të vendosen zyrtarët e PK-së.

Janë liruar lokalet e uzurpuara me asistimin e inspektionit nga Komuna e Mitrovicës dhe Policisë së Kosovës. Lokali i liruar me vete bartë edhe pasojat nga mospagesat e qirasë në vlerë prej 19,000.00€ dhe borxhe ndaj KESCO në vlerë prej 28,000.00€. Disa lokale i kanë dëmtuar orët e ujit.

Zyrtarët e KESCO pretendojnë se borxhin ndaj tyre për obligimet e painkasuara duhet t'i kompenzoj NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. ose qiramarrësi i ri për çka kemi angazhuar avokat për ta shqyrtuar lëndën dhe barra e borxhit të bie tek qiramarrësi.

Me operatorin ekonomik Arjeta Group duke u bazuar në rregulloren e brendshme me nr protokoli 57-07/04/2023 e titulluar "RREGULLORE PËR DHËNJËN ME QIRA TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË NDERMARRJËS PUBLIKE LOKALE " lëshuam një pjesë të objektit me qira me hapësirë prej 843.75m². Kjo marrëveshje është e bazuar në rregulloren e brendshme të lart cekur duke e kategorizuar qiramarrësin si investitor strategjik në nenin 2 pika 1.7 dhe 1.8, marrë parasysh gjendjen egzistuese të NPL "SAM" SH.A. që pothuajse është i shkatërruar në terësi, pjesë përbërëse të investimeve kapitale në objekt janë të përfshira në kontratë duke specifikuar pozicionet e renovimeve dhe instalimeve të reja që do të ndodhin sepse ato egzistueset nuk përballojnë nevojat dhe kërkesat aktuale të të gjitha subjekteve afariste që operojn në kuadër të NPL "SAM" SH.A.

Kontrata është nënshkruar për periudhën 15 vjeçare bazuar në ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim e pronës së paluajtshme të Komunës 06/L-092 i datës 07/03.2019. Kontrata përfundimtare është nënshkruar me datë 30.06.2023.

Është bërë njoftimi për kontraktorët borxhlinjë për procedurat përmbarimore tek përmbaruesit privat.

Është hartuar dhe aprovuar Biznes Planin për vitin 2023, i cili është dashur të hartohet nga menaxhmenti paraparak.

Kemi zhvilluar takim me inspektorin nga Ministira e Transportit Z. Hasan Ibraj, me këtë rast i kemi shpalos qështjet të cilat e preokupojnë aktivitetin e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. dhe nga i njëjti kemi marrë përkrahje të plotë në eliminimin e dukurive negative të cilat po i shkaktojnë operatorët ekonomik, duke i respektuar rendet e udhëtimit dhe duke i përmbushur obligimet e rregullta.

Është rregulluar qështja e ndriçimit të peronave si hap i domosdoshëm.

Është instaluar zyrtarisht E-Prokurimi në faqen zyrtare të KRPP-së dhe është siguruar zyrtari i licencuar i prokurimit.

Janë nënshkruar disa kontrata të rregullta duke u bazuar në "Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Ndërmarrjes Publike Lokale "SAM" me operatorët ekonomik.

Grandi i shpërndar nga Komuna e Mitrovicës është inkasuar në llogarinë bankare në vlerë prej 50,000.00€ me datë 26.06.2023 me destinim riparimin e kulmit të objektit.

Kemi angazhuar Auditorë të Jashtëm për auditimin e gjendjes së NP "Stacioni i Autobusëve" për periudhën 2020, 2021 dhe 2022. Të gjeturat themelore të auditorëve për periudhën e lartëcekur janë si vijon:

1. Rivlersimi i aseteve-toka, objekti dhe paisjet;
2. Mosbalancimi i llogarive të pagueshme me operator ekonomik;
3. Mungon procedura e menaxhimit të parasë së imët (arka);
4. Mungon evidenca për menaxhimin e kilometrave (edhe pse janë përdorur makinat personale);
5. Mungon komisioni për regjistrimin e pasurisë së ndërmarrjes;

6. Mungojnë dokumentet e Llogarive të Arkëtueshme të regjistruara në Pasqyra Financiare e potenciuar specifikisht vlera prej 388,000.00€ me AKP-në;
7. Mungojnë konfirmimet me llogaritë e arkëtueshme;
8. Mungon procedura për paradhënie (avance);
9. Llogaritë e pagueshme të mbetura në histori, TVSH, paga, kontribute në vlerë prej 961.11€;
10. Mungojnë konfirmimet për llogaritë e pagueshme;
11. Mungojnë procedurat për menaxhimin e blerjeve;
12. Mungojnë procedurat e prokurimit.

Nga të gjitha të gjetura për vitet 2020, 2021 dhe 2022 si konkluzion Auditori i Jashtëm ka dhënë opinionin e "Kualifikuar".

Janë shqyrtuar 5 lëndë pran Gjykates Themelore.

Janë marr vendime për lirimin e kioskave para stacionit të autobusëve, ku kemi zhvilluar negociata të vazhdueshme me inspektoratin dhe drejtoritë kompetente komunale.

Është hartuar Biznes Plani për vitin 2024. Ku këtë projekcion të biznes planit e kanë përcjell një varg sfidash duke potenciuar investimin në kulmin e objekti, projektin e dixhitalizimit dhe risku i investimeve nga operatori ekonomik për shkak të rrymës, ujit, dhe lirimit të hapsirave.

Kemi zhvilluar disa takime me specialist nga prokurimi, ku ka dështuar zyrtari i prokurimit nga komuna përkundër nënshkrimit të kontratës dhe futjen e tij në listen e pagave. Në vazhdën e kësaj për të gjetur zgjidhje kemi kontaktuar edhe me zyrtar të prokurimit nga Trepça SHA, KRU-Mitrovicë, KK Prishtinë dhe disa zyrtar të tjerë por pa rezultatet të pritshme, si shkak kryesor i mos arritjes së marrëveshjes ishte paga e ulët e ofruar për nënshkrim të marrëveshjes.

Gjatë muajve të lartë cekur zyra juridike e ndërmarrjes ka bërë shqyrtimin e disa lëndëve gjyqësore të NPL "SAM"SH.A. Gjatë muajve paraprak kanë qenë pjesëmarrës në disa lëndë gjyqësore:

Pagesa e Borxhit për kreditorët për lëndet: E.nr.572/2010, C.nr 1180/19, C.nr.364/23 dhe C.nr.847/2018 Komuna e Mitrovices-AKP. Të gjitha lëndet e lartcekura kanë marrë epilog pozitiv në favor SAM. Lëndë e tjera në të cilat kemi qenë pjesëmarrës nuk kanë marrë vendim të formës së prerë.

Vazhdojmë të kemi aktivitete lidhur me angazhimin e stafit në kontaktimin me operator ekonomik për rritjen e inkasimit të hyrave dhe zvogëlimin e shpenzimeve, në vazhdën e saj kemi disa sfida të vazhdueshme me operator të cilët nuk po i pranojnë faturat. Në drejtim të saj faturat të cilat operatorët nuk i kanë pranuar po i dërgojmë nëpërmes postës.

Nëpërmes zyrës së prokurimit nga Komuna e Mitrovices kemi zhvilluar dy procedura për furnizim të zyreve.

Kemi pas angazhime në vazhdimësi me avokatin dhe ZRRE për çështjen e rrymës të papaguar nga klienti e cila po paraqet probleme gjatë aktiviteteve të investimeve.

Janë zhvilluar takime në vazhdimësi me drejtor të Komunës së Mitrovicës për kioska dhe sfida të tjera me të cilat po ballafaqohet stacioni, si tatimi në pronë, asetet e stacionit, dhe kërkesa zyrtare për heqjen dhe zhvendosjen e kioskave etj.

Kemi lidhur kontrat për shfrytëzimin e hapësirës prej 65 m² me IPKO Telecommunications L.L.C.

Me datë 07.07.2023. është marrë vendimi fillestar nga menaxhmenti për shkëputje të kontratave me kioska, kurse me datë 30.11.2023 është marrë vendimi për largimin dhe zhvendosjen e kioskave. Në zbatimin e vendimit ka marrë pjesë edhe Inspektorati Komunal dhe Policia e Kosovës. Aktualisht jemi në bisedime me organet kompetent për të gjetur zgjidhje lidhur me zhvendosjen e kioskave.

Investimet nga “Arjeta Group” të cilat janë zhvillim e sipër në objektin e lëshuar me qira sipas kontratës janë duke u zhvilluar, sfida në këtë drejtim është çështja e rrymës, ujit dhe kioskave të cilat ende nuk i kanë liru hapësirat. Në këtë drejtim kemi zhvilluar takime të shumëta për adresimin e problemeve me qiramarrësin.

Kemi zhvilluar disa takime me KRU Mitrovica për problematikën e ujit. Ku edhe kemi bërë një marrëveshje për riprogramim të borxhit

Është zhvendosur poligoni për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – njësia për patent shofera.

Është lëshuar vendimi për mos parkim të veturave personale të stafit dhe operatorëve ekonomik.

Është arritur marrëveshja e mirëkuptimit me Universitetin “Isa Boletini”: Mitrovicë për nevoja të ndërmarrjes publike lokale nga lëmi i prokurimit publik sipas nr. të protokollit 224/23 të datës 14.12.2023.

Kemi paraqitur kërkesë pranë organeve kompetente të KEDS-it që urgjentisht të shkyqin nga furnizimi me energji elektrike operatorët ekonomik (KIOSKAT), të cilat gjenden në NPL “SAM” Sh.A të cilët janë pa kontrata që nga data 01.09.2023 dhe nuk janë të lejuar të operojnë në ndërmarrje.

5. Pasqyra e strukturës organizative

5.1 Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore ne ndërmarrje

NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Mitrovicë, ka Bordin Drejtues (BD), nga Komuna e Mitrovicës, e cila është aksionar i ndërmarrjes, Kryeshefin Ekzekutiv (KE), Zyrtarin Kryesorë Financiar (ZKFTH), Sekretarin, të zgjedhur nga BD-ja si dhe nuk ka plotësuar pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm (ZAB).

Bazuar ne skemën organizative gjatë vitit 2023 kanë qenë të punësuar 22 punëtor, prej tyre 15 meshkuj dhe 7 gra, me një moshë mesatare prej 46 vitesh të të punësuarve.

Struktura organizative e ndërmarrjes – organogrami është paraqitur ne shtojcën a.

5.2 Lëvizjet e stafit gjatë vitit 2023

Pensionimet: Si rezultat i arritjes së moshës së pleqërisë, gjatë kësaj periudhe kemi pasur 4 pensionime të punëtorëve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Pushimet vjetore: Gjatë kësaj periudhe kohore të gjitha pushimet vjetore janë realizuar sipas kërkesave të punëtorëve dhe aprovimit dhe planifikimit të mbikëqyrësve të tyre në bashkëpunim me

6. Financat

NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A Mitrovicë, krijon të hyrat nga shërbimet e ndryshme të ofruara nga ndërmarrja.

Shërbimet kryesore nga të cilat krijohen të hyrat e ndërmarrjes janë si vijon:

- Shërbimi i peronizimit – i cili paguhet nga të gjithë auto transportuesit e regjistruar në Mitrovicë dhe jashtë saj të cilët posedojnë linja të regjistruara dhe të lejuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues për linjat ndër-urbane dhe urbane. Çmimorja për këtë shërbim është përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve.
- Shërbimi i parkingut – ndërmarrja posedon një hapësirë e cila shfrytëzohet për parking të veturave private, veturave të auto shkollave si dhe autobusëve.
- Lëshimi i hapësirave afaristë me qira – ndërmarrja ne kuadër të hapësirës se saj posedon 29 lokale të cilat i lëshon me qira në baza vjetore dhe nga të cilat krijon të hyra të vazhdueshme mujore.

Me qëllim që ndërmarrja të jetë funksionale posedon shpenzime lidhur me paga dhe mëditje për staf, përfshirë dhe shpenzimet për paga dhe mëditje për anëtarët e bordit si dhe zyrtarët e lartë të ndërmarrjes. Gjithashtu, janë të evidentuara edhe shpenzimet operacionale dhe ato administrative si dhe shpenzimet e zhvlerësimit të Stacioni i Autobusëve Mitrovicë ndërtesës së ndërmarrjes dhe pajisjeve të ndryshme të cilat i ka në funksion ndërmarrja.

6.1 Të hyrat

Nga zërat bilancor 30.7% e të gjitha të hyrave të ndërmarrjes krijohen nga shërbimi i peronizimit i cili paraqet shërbimin kryesor në krijimin e të hyrave.

Të hyra tjera me rëndësi janë të hyrat nga qiratë të cilat paraqesin ne total 25.3% e të gjitha të hyrave totale. Të hyrat nga qiraja, realizohen nga bizneset dhe aktivitetet e tyre biznesore që zhvillojn aktivitet në hapësirën e ndërmarrjes

Një pjesë e hapësirës së stacionit shfrytëzohet për parking me pagesë, i cili shërbim paraqet të hyra të rëndësishme për ndërmarrjen. Gjatë vitit kjo e hyrë participon me 6.2% e totalit të hyrave.

Të hyrat tjera, subvencionet dhe shitja e mbetjeve participojn me 37.8% në totalin e të hyrave të vitit aktual.

Në vitin 2023, Komuna e Mitrovices ka ndar subvencione në vlerë prej 50,000€.

Duke krahasuar të hyrat me vitin paraprak 2022 kemi rritje të hyrave prej 91.1% apo shprehur në vlerë kemi 79,089.00 € rritje krahasuar me vitin e paraprak.

Tabela nr. 1. Të hyrat

Përshkrimi i të hyrave	2023	2022	Struktura (%)
Shërbimi i peronizimit	50,880	48,333	26%
Shërbimi i parkingut	10,228	-	-
Qiratë nga lokalet	41,966	38,401	9%
Të hyra tjera	62,749	-	-

Totali i të hyrave	165,823	86,734	91%
---------------------------	----------------	---------------	------------

6.2 Shpenzimet -Kategoritë e shpenzimeve

6.2.1. Shpenzimet për paga dhe mëditje

Sa i përket shpenzimeve lidhur me paga dhe mëditje në kuadër të ndërmarrjes njihen këto kategori: kompensimi për anëtarët e bordit të drejtorëve, pagat dhe mëditjet për punëtorët e ndërmarrjes përfshirë edhe zyrtarët e lartë.

Krahasuar me vitin paraprak rritje të pagave prej 7.7% sa i përket këtyre shpenzimeve. Kjo rritje është shënuar si derivat i rritjes së numrit të punësuarve dhe pagesave të rregullta të pagave për Bordin Drejtues.

Tabela nr 2. Shpenzimet e pagave

Përshkrimi i pagave	2023	2022	Stabilitet (%)
Pagat e stafit	78,589	83,095	-5%
Pagat e bordit	15,220	3,976	377%
Totali i pagave	93,809	87,071	7.7%

6.2.2 Shpenzime operative

Në shpenzimet operative bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me funksionalizimin e mirëfillt të ndërmarrjes. Në këtë kategori bëjnë pjesë shpenzimet e rrymës, shpenzimet e ujit, shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzime për mirëmbajtje të energjisë elektrike si dhe shpenzime tjera të paraqitura detajisht në tabelën e mëposhtme. Shpenzimet operative krahasuar me vitin pararak janë rritur për 470%, ose shprehur në vlerë për 2 5,459€. Pozicion themelor i cili ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve janë shpenzimet e ujit dhe shpenzimet për renovimin e zyrave. Gjatë vitit 2022 vlen të theksohet se nuk ka pas faturim për ujë edhe pse realisht ka pas shpenzime dhe defekte të ujit dhe ora ka regjistruar në baza mujore rreth 1,000.00€ shpenzime të ujit.

Tabela nr 3. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative	2023	2022	Stabilitet (%)
Telefonia mobile	204	60	340%
Telefonia Fikse dhe interneti	89	173	-51%
Interneti	237	-	-
Derivateve	-	424	-
Shpenzimet e rrymës	2,549	2,722	-9.3%
Shpenzimet e ujit	9,309	-	-
Shpenzime për mbeturina	142	-	-
Shpenzime për materiale Sanitare-Higjienike	585	-	-
Mirëmbajtje dhe renovimi i objektit	8,199	1,640	500%
Pjese rezerve për parking dhe laura	-	-	-
Pajisje IT	-	-	-
Tjera (Tatimi në pronë, Auditimi, provizionet, KPP).	11,031	1,867	591%

Totali i kostove operative	32,345	6,887	470%
-----------------------------------	---------------	--------------	-------------

6.2.3. Shpenzime Administrative

Shpenzimet administrative i përkasin shpenzimeve që lidhen direkt me funksionalizimin administrativ të ndërmarrjes. Në këto shpenzime hyjnë shpenzimet lidhur me materialin për zyre, shpenzimet e reprezentacionit, mirëmbajtja e softverit financiar, etj. Kostot administrative janë rritur krahasuar me periudhën paraprake për 1,358% apo shprehur në vlerë për 5,060€.

Tabela nr. 4 Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative	2023	2022	Shënimet
Materiale për zyre	1482	271	548%
Reprezentacion (Përfaqësim)	710	131	542%
Shërbimi i auditimit	3,000	-	-
Mirëmbajtje e softuerit dhe rrjetit	250	-	-
Material elektrik	-	-	-
Shpenzime administrative të tjera	19.20	-	-
Totali i kostove administrative	5,461	402	1,358%

Shpenzimet e lidhura për vitin 2023 inkorporojnë në vetë edhe shpenzimet vjetore të trustit pensional për të punësuarit në vlerë prej 4,960€, shpenzimet për mirëmbajtjen e llogarisë bankare dhe provizionet në vlerë prej 668.8€.

6.2.4. Shpenzimet Investive

6.2.5. Shpenzimet e zhvlerësimit

Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2023 nuk kemi meqenëse investimi në vijim pritet të përfundojë në vitin vijues. Zhvlerësimi i pasurisë së ndërmarrjes bëhet konform ligjit mbi pasuritë joqarkulluese. Vitin aktual kemi kapitalizim të investimeve në objekt si rezultat i bashkpunimit dhe nënshkrimit të kontratës për investime me operator privat.

Tabela nr. 5 Shpenzimet e zhvlerësimit

Shpenzimet e zhvlerësimit	2023	2022	Shënimet
Ndërtesa	-	28,896	-
Pajisjet e zyrave	-	1,249	-
Totali i kostos së zhvlerësimit	-	30,145	-

6.2.6. Fitimi (Humbja) para tatimit

Në vitin 2023, NPL "Stacioni i Autobuseve" SH.A Mitrovicë, ka operuar me fitim prej 28,848.00€. Kurse totali i shpenzimeve të ndërmarrjes është 136,975€. Në vitin paraprak (2022) biznesi ka pasur humbje në vlerë prej 7,625€.

Tabela nr. 6 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	Shuma (€)
Të hyrat	165,823
Pagat	93,809
Kosto operative	32,345
Kosto administrative	10,820
Totali i kostove investime	-
Zhvlerësimi	-
Fitimi para tatimit (EBIT)	28,848

7. Çështjet juridike

Me datë: 10.01.2023 ka filluar punë Sekretari i Përgjithshëm i Ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Mitrovicë ku nga dita e parë gjerë me datë: 31.12.2023, ka kryer një varg punësh të cilat edhe janë pjesë e detyrave dhe përgjegjësi të Sekretarit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes. Vlen të ceket se ndaj ndërmarrjes publike stacioni i autobusëve janë ushtruar 25 padi kryesisht nga puntorët të cilet kërkojnë kompensim në të ardhura personale kurse 7 punëtor nuk kanë ushtruar padi ndaj ndërmarrjes. Vlera e listes së punëtorve që kanë ushtruar padi është 128,376.02.

Me datë: 28.04.2023 Zyra Juridike ka pranuar një shkresë (AKTVENDIM) nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, për të paditurin Kamer Bislimi (Qiramarrës) me numër të lëndës C.nr.165/2023 Objekt i kontestit: pagesë për borxhin mbi qiranë. Aktvendimi – ndërpret procedurën në këtë çështje kontestimore të paditësit kundër të paditurit Kamer Bislimi, pasi që personi në fjalë ka ndrrue jetë. Gjithashtu me datë: 19.05.2023 kemi pranuar edhe një shkresë (AKTVENDIM) nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në çështjen juridike të paditësit ALI HASANI nga Mitrovica kundër të paditurit NPL "SAM" Sh.A. objekt i kontestit: pagesa e të ardhurave personale, padia dhe kërkesë padia është tërhequr nga Ndërmarrja.

Gjithashtu me datë: 26.04.2023 kemi pranuar edhe një shkresë (AKTVENDIM) nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në çështjen juridike të paditësit Sofije Ismajli nga Mitrovica kundër të paditurit NPL "SAM". Objekt i kontestit: pagesa e të ardhurave personale. Vendim padia dhe kërkesë padia është tërhequr nga Ndërmarrja. Gjithashtu kemi pranuar edhe disa shkresa të cilat po i shpalosim shkurtimisht (AKTVENDIM) nga Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në çështjen juridike të paditësve nga Mitrovica kundër të paditurit NPL "SAM" SH.A.

1-Aktvendime - për 32 punëtor nga Njësia e Skenderajit. Lënda e Kontesti-Kompensim i të ardhurave personale. Padia dhe kërkesë padia është tërhequr nga Ndërmarrja.

2-Aktvendime - për Musa Fazliu. Lënda e Kontesti-Kompensim i të ardhurave personale. Nuk ka aktvendim të formës së prerë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.

3-Aktvendime- për punëtorin Fadil Ademi - Lënda e Kontestit-Kompensim i të ardhurave personale. Padia dhe kërkesë padia është tërhequr nga Ndërmarrja.

4-Aktvendime- për ish-Kryeshefen e ndërmarrjes - Lënda e Kontesti-Kompensim i të ardhurave personale. Padia dhe kërkesë padia nuk është tërhequr nga Ndërmarrja (pas pranimit të ekspertizës financiare seanca do të mbahet me dt 14.03.2024).

Me datën 10.01.2023 në zyrat e administratës së stacionit të autobusëve është bërë pranim-dorëzimi në mes të kryeshefit Xhavit Hasanit dhe Esat Jusufi të kryeshefit ekzekutive aktual. Gjatë muajit janar kanë filluar punën Kryeshefi Ekzekutiv si dhe Sekretari i ndërmarrjes NPL "SAM" SH.A.

Në muajin janar me datën 01.03.2023.. ka filluar punën Zyrtar Kryesor Financiar.

Në muajin shkurt me datën 14.02.2023 është bërë ndryshim-plotësim i statutit të ndërmarrjes lokale stacioni i autobusëve.

Me datën 23.02.2023 është nënshkruar marrëveshja – kontrata për kryerjen e shërbimeve postare.

Me datën 10.03.2023 kryeshefi ekzekutiv nxjerr vendim për lirim të hapësirave (lokaleve) të uzurpuara në NPL (ARS DHE DARISI).

Me datën 07.04.2023 është aprovuar/miratur nga Komisioni Aksionareve dhe Bordi i Drejtorëve "Rregullorja për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

Kurse me datën 06.06.2023 me nr. protokollit 92/23 është aprovuar Plani i Biznesit për vitin 2023.

Në vijim me datën 30.06.2023 me nr. rendor/112 u lidh kontrata ndërmejt "Arjeta Group" dhe NPL "SAM"SH.A.

Mbledhje të Bordit në vitin 2023, janë mbajtur në administratën e NPL"SAM"SH.A. gjithësejt 16 mbledhje, 12 të rregullta dhe 4 të jashtëzakonshme. Me datën 13.04.2023 rezultoi një vendim për punëtorët e ndërmarrjes ku është shpërndarë një pagë solidarizuese në lartësi prej 50.00€ për secilin të punësuar. Procedurat e pranimit të stafit menaxherial janë zhvilluar konform rregullave ligjore për rekrutimin e stafit.

Me datën 15/12/23 me nr. protokoll 225/23 është lidhë kontratat për shërbime të veçanta ndërmejt palëve NPL"SAM"SH.A. dhe Universitetit "Isa Boletini" për zyrtaren e çertifikuar për pokurim.

Për shfrytëzimin e shërbimeve të stacionit në bazë të rregullores për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të ndërmarrjes publike lokale janë lidhë kontrata me disa operatorë ekonomik.

Kemi kryer marrëveshjen mes të NPL "SAM"SH.A. dhe "Ujësjesit Rajonal" SH.A për riprogramim e borxhit me kompaninë me datën 12.12.2023 me nr. protokollit nr.223/23.

Gjithësejt në NPL"SAM"SH.A. në fund të vitit 2023 kanë qenë 22 punëtorë. Struktura e tyre përbëhet si vijon: pozita menaxhuese Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari i Lartë Financiar dhe Sekretari i Përgjithshëm. Struktura kualifikuese përbëhet nga 9 punëtor me kualifikim superior, 1 me kualifikim të shkollimit të lartë, 10 me shkollim të mesëm dhe 2 me shkollim të ultë.


8. Transaksionet e prokurimit

Gjatë vitit 2023, janë shënuar 2 transaksione të prokurimit për furnizim me shërbime dhe materiale të ndryshme për nevojat e ndërmarrjes duke respektuar ligjin dhe procedurat e prokurimit publik (LPP) në vlerë prej 900.00€.

8.1 Planifikimi për vitin vijues

Menaxhmenti i ndërmarrjes përveç gjenerimit të mjeteve vetanake do të vazhdojë të kërkojë burime të ndryshme të financimit edhe gjatë vitit të ardhshëm. E gjithë kjo do të varet në bazë të situatës financiare të SAM nga afarizmi i zhvilluar. Prioritet do të jetë vendosja e lauarave në hyrje-dalje të stacionit, meremetimi i zyrave të stacionit duke përfshirë fasaden, ndrrimin e dymëve dhe dritareve, vendosjen e ATM të bankave komerciale, kioska për qender të informimit, investime në lokalet e pamermetuara, investime në rregullimin e kulmit, rregullimin e nyjeve sanitare dhe kanalizimit.

Shtojca 1: Organogrami



*Legjenda

- POZITA-KOMISION I AUDITIMIT (E ZBRAZET)
- POZITA – SHEF I KONTABILITETIT (E ZBRAZET)
- POZITA – ZYRTAR I TI (E ZBRAZET)